

Shkodër, më _____.____.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

**OBJEKTI I PROCEDURËS: FURNIZIM VENDOSJE I SISTEMIT TE DETEKTIMIT TE
ZJARRIT NE PYJE**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV: 31625200-5 - Sisteme alarmi anti-zjarr, 45312100-8 - Instalime sistemesh për alarm në rast zjarri

VLERA E FONDIT LIMIT: 13,613,544 (Trembedhjetemilion e gjashtëqind e trembedhjetemije e peseqind e dyzet e kater) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Shkodër** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin76” Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbeshtetje te Nenit 26”Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin përmbledhës te vetdeklarimit, sipas*

parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”*,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

1. *Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 8).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021-2022-2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës që prokurohet dhe konkretisht **13,613,544** (Trembedhjetemilion e gjashtëqind e trembedhjetemije e peseqind e dyzet e kater) lekë

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “*Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën*”, “*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës*”, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/b, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.*

Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

Duke marre ne konsiderate vleren e fondit limit te kesaj procedure prokurimi, kërkohet qe OE ofertues te paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë ne kohe dhe ne përputhje me specifikimet teknike te kërkua. Për ketë, OE ofertues duhet te ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qellim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **13,613,544** (Trembedhjetemilion e gjashtëqind e trembedhjetemije e peseqind e dyzet e kater) lekë qe eshte sa vlera e fondit limit dhe vendosja e ketij limiti nuk kufizon pjesemarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkua për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2021-2022-2023 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkua për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar).

Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën

vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2024 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2024.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrorjnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate në një vlerë prej **5,445,417** (Pesemilion e katerqind e dyzet e pesemije e katerqind e shtatembedhjetë) lekë.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen:

- Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.
- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 "Kërkesat për kualifikim", të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" pika 4.. "ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zoterojnë burimet e nevojshme njëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të pershtatshëm cilesie. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të pershtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën" dhe nenin 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është midis kufirit të ulët dhe të lartë monetar, vlera për furnizime të ngjashme prej **5,445,417** (Pesemilion e katerqind e dyzet e pesemije e katerqind e shtatembedhjetë) lekë, përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe në këto mënyra, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës dhe është në masën 40% të fondit limit.

2.3.2 Operatori Ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme si më poshtë:

- ISO 9001:2015. Çertifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i certifikimit të operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet
- ISO 27001, për menaxhimin e sigurisë së informacionit Çertifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i certifikimit të operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet
- ISO 20000-1 për menaxhimin e shërbimeve IT Çertifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i certifikimit të operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,*

...“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

... “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

a) ISO 9001:2015 ‘Sistemi I menaxhimit të cilësisë’

ISO 9001 (ose ekuivalente) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij. Kërkesa për ISO 9001 ose ekuivalente, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

b) ISO 20000-1 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të shërbimit të teknologjisë së informacionit;

Standardi ISO 20000-1 (ose ekuivalente) përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohen në teknologjitë e informacionit.

ISO 20000-1 është një kuadër standardizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomike për: ndjekjen konsistente të shërbimeve përgjatë afatit të zbatimit të kontratës, sipas kërkesave të DST-së.

Kjo certifikatë ose ekuivalentja e saj, siguron Autoritetin Kontraktor që të gjitha punimet që do të realizohen përgjatë kohëzgjatjes së kontratës, do të menaxhohen sipas standardeve më të mira të shërbimeve të teknologjisë së informacionit.

c) ISO 27001 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të sigorisë së informacionit;

ISO 27001 është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me :

- *mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security Management System) brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik.*
- *aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.*
- *aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.*
- *aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambiente sensitive.*

Referuar sa më sipër cituar, ky standard i kërkuar, lidhet ngushtësisht dhe drejtpërdrejtë me zërat e kërkuara objekt kontrate.

- 2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqese autorizim prodhuesi/**distributori** per furnizimin dhe suportin per pajisjet e ofruara me poshte. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij. Ne rast se do te paraqitet autorizim distributor operatori ekonomik ta vertetoj kete duke paraqitur kontratë premtimi, letër angazhimi / akt-marreveshje lidhur mes Kompanisë prodhuese dhe Distributorit të autorizuar.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për mallrat e furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion përkatës. Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Në këtë kontekst, referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dëshmive nga prodhuesi për pajisjet/artikujt e ofruara, e cila është vendosur në përputhje me Specifikimet Teknike të procedurës, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me cilësitë e artikujve dhe nevojës për garanci mbi efincencën dhe kapacitetet teknike të pajisjeve/ artikujve.

- 2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë kataloge ose broshura për mallin që oferton duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga artikujt e kuotuar sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. (Katalogu të permbaje karakteristikat teknike të çdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të percaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të modelit të kuotuar do të krahasohen me katalogun e pajisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmerinë e tyre). **(Pjesa e katalogut që përfshin specifikimet teknike të jete e perkthyer)**

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/c, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për mallrat e furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion përkatës. Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Në këtë kontekst, referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dëshmive nga prodhuesi për pajisjet/artikujt e ofruara, e cila është vendosur në përputhje me Specifikimet Teknike të procedurës, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me cilësitë e artikujve dhe nevojës për garanci mbi efincencën dhe kapacitetet teknike të pajisjeve/ artikujve.

- 2.3.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të lëshojnë deklaratë nëpërmjet të cilës merr përsipër montimin, instalimin, konfigurimin, testimin për pajisjet si dhe të marrë përsipër të trajtojë stafin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.6 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar prej 3 (tre) muajsh nga data e fillimit të kësaj procedure, të pakten 6 (gjashtë) punonjës.

OE duhet të plotësojë si më poshtë:

- Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per menaxhimin e projekteve ose ITIL (ose ekuivalent) .
- Te pakten 1 (një) inxhinier elektrik.
- Te pakten 1 (nje) punonjës te certifikuar per sisteme CCTV.
- Te pakten 1 (nje) punonjës te certifikuar per sisteme VMS.
- Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per pajisjet server.
- Te pakten 1 (nje) punonjes te pajisur me kartela te sigurimit teknik. (alarmit)

Per te provuar kriteret e mesiperme operatori ekonomik duhet te paraqese:

- I. diplomat përkatëse për inxhinieret e mesiperme/Certifikaten e kërkuar;
- II. (listëpagesat e sigurimeve shoqërore për gjithë stafin e sipërkërkuar sipas formatit E-Sig për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për të pakten muajin e fundit ku punonjësit e kërkuar duhet të figurojnë në këto listpagesa të siguruar me kodin përkatës për muajin e fundit).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” në nenin 40, pika 5, gërma b/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Është kërkuar inxhinier elektrik për zbatimin e punimeve në përputhje me zerat e punimeve të preventivit, punime elektrike dhe montim dhe konfigurim pajisje elektronike si dhe specifikimeve teknike që do të zbatohen dhe si dhe kategorive përkatëse në licencën përkatëse të zbatimit, Është kërkuar 1 (nje) punonjes te certifikuar per menaxhimin e projekteve ose ITIL (ose ekuivalent) , kjo për të ofruar zgjidhjet e softëerit kjo e specifikuar në materialin e specifikimeve dhe studimin për funksionimin në tërësi të sistemit. Është kërkuar të pakten 1 (nje) punonjës te certifikuar per sisteme CCTV punonjës për instalimin e sistemit i përcaktuar qartë në studimin

dhe specififikimet. Është kërkuar te pakten 1 (nje) punonjës te certifikuar per sisteme VMS , kjo për të menaxhuar sistemin e kamerave të cilat do të instalohen në vendin e caktuar, Është kërkuar Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per pajisjet server kjo për arsye të programimit fizik dhe virtual të sistemit.Eshte kerkuar te pakten 1 (nje) punonjes te pajisur me kartela te sigurimit teknik. (alarmit) ne instalimin e sistemeve te alarmit.

Vendosja e ketyre kriterëve te kualifikimit, eshte pjese e domosdoshme ne funksion te realizimit me sukses te kontrates, pasi pajisjet do te montohen, implementohen dhe Serveri do të përdoret për të instaluar softëare që do të detektojë zjarret dhe për të regjistruar videon e kamerave të instaluara, do te provohen nese i kryejne funksionet sipas specifikimeve teknike, do te instalohen aplikacionet apo softëeret perkatese etj.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila të përmbaje kategoritë e mëposhtme:

Punime speciale ndertimi:

NS 13-A Nivelii A "Impiante dhe linja telefonie, telekomunikacioni";

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 40, pika 5, gërma a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet te sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.." Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zerat e punimeve te ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të

gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqese nje Deklaratë mbi origjinën e mallit, ku të përcaktohet qarte: Firma prodhuese, Vendi i prodhimit dhe Modeli i ofruar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance,apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalentii tij/saj”.***